



Instituti për Studimet Publike&Ligjore
Institute for Policy & Legal Studies
IPLS/ISPL

STUDIM

Analizë krahasimore e kuadrit ligjor për Median Online
me standardet Europiane dhe praktikatat më të mira

MAJ 2019
Tiranë

PËRMBAJTJA

SHKURTIME2

□	Përmbledhje ekzekutive	4
	I. HYRJE	6
	II. STANDARDET EUROPIANE MBI MEDIAN ONLINE	9
	2.1 Bashkimi European dhe vendimet e GJDBE, me fokus median audiovizive	10
	2.2 Këshilli i Europës dhe vendimet e GJEDNJ, me fokus median on-online	16
	III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME KYÇE	23
□	ANEKSE	26
□	BIBLIOGRAFIA	27

- **SHKURTIME**

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” - **Ligj 97/2013**¹

Ligji nr. 9918 , datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar - **Ligji nr.9918/2008**²

Ligji nr.10128, datë 11.5.2009, "Për tregtinë elektronike" - **Ligji nr.10128/2009**³

Autoriteti i Mediave Audiovizive - **AMA**

Autoritet i komunikimeve elektronike dhe postare - **AKEP**

Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv - **OSHMA**

Ofruesit e Shërbimeve të Publikimeve Elektronike- **OSHPE**⁴

Direktiva e Shërbimit të Mediave Audio-Vizive të BE⁵ - **Direktiva/ DSHMAV**

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian - **GJDBE**

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut - **GJEDNJ**

Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore - **EPRA**⁶

¹ Ndryshuar me ligjin nr. 22/20163, datë 10.3.2016, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.56, datë 27.7.2016 dhe ligjin nr. 91/2017, datë 22.5.2017.

² Ligji nr.102/2012, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

³ I ndryshuar me Ligjin nr. 135/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”

⁴ Sipas shtesave të propozuara në projekt -ligjin nr.97/2013. Për më tepër: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/120>

⁵ (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë, versioni i kodifikuar), Numri CELEX: 32010L0013, Fletore Zyrtare e BE-së, Seria L 95, datë 15. 4. 2010.

⁶ <https://www.epra.org/>

Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është garantuar. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.

(neni 22 i Kushtetutës)

E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

(neni 23 i Kushtetutës)

Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

(neni 8 i KEDNJ)

Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kushtëzimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

(neni 10 i KEDNJ)

- **Përmbledhje ekzekutive**

ISPL, nën kërkesën e AMA-s, mori përsipër angazhimin për realizimin e këtij Studimi me qëllim analizën krahasimore të standardit Europian mbi lirinë e medias online, si dhe prezantimin e gjetjeve dhe bërjen e rekomandimeve përkatëse.

Interneti është bërë mjete kryesor me anë të të cilit, individët ushtrojnë lirinë e shprehjes, për të marrë informacion të paanshëm, dhe për të siguruar kështu, një mjet thelbësor për pjesmarrje në aktivitete dhe diskutime lidhur me çështje politike apo çështje të tjera të interesit të përgjithshëm. Për më tepër, interneti luan rol të rëndësishëm në rritjen e aksesit të publikut për lajmet, si dhe për lehtësimin e qarkullimit të informacionit në përgjithsi. Përdoruesit e aktiviteteve të shprehura në internet sigurojnë një platformë të paprecedentë për ushtrimin e lirisë së shprehjes. Zhvillimet e shpejta, dinamike, dhe teknologjite e përparuara, e kanë bërë median on - line, metodën më të shpejtë dhe informative. Kjo lloj dinamike është e mbarsur me shqetësime tepër serioze mbi kufijtë mes lirisë së shprehjes dhe ruajtjes së dinjitetit njerëzor, si dhe debate të gjera në trend global, ashtu si dhe lokal mbi kufijtë dhe balancat mes lirisë së medias, lirisë së shprehjes dhe të drejtës për ruajtjen e personalitetit, dinjitetit njerëzor dhe jetës private të individit, shqetësime që edhe në terrenin shqiptar po gjejnë një lloj adresimi në nivel ligjërje, politikash, dhe mbrojtjeje gjyqësore, si garanti final i raporteve ballancuese të këtyre vlerave shoqërore dhe ligjore⁷. Në fund të vitit të kaluar, (dhjetor 2018), u ndërmor një iniciativë për reformimin e mëtejshëm të ligjeve mbi mediat on-line dhe audiovizive. Këto projektligje, përkatësisht “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikojnë regjistrim, mbikqyrje, gjobitje dhe mbyllje të mediave on-line dhe/apo audiovizive, veprimtaria e të cilave bie në kundërshtim me parashikimet përkatëse ligjore. Në kushtet e konsultimit publik dhe një debati të lartë lidhur me këto iniciativa ligjore, ky Studim u bë i nevojshëm, me qëllim diagnostikimin e kuadrit ligjor Shqiptar nën optikën e standardeve ndërkombëtare mbi lirinë e shprehjes.

Ky Studim u bazua kryesisht në *desk research*, pas një analize të hollësishme krahasimore të legjislacionit dhe praktikës gjyqësore ndërkombëtare në fushën e medias, dhe lirisë së shprehjes. *Hard and soft law* janë pjesë e Studimit, dhe janë pasqyruar në të, si standarde detyruese, ose orientuese dhe rekomanduese, në çdo përpjekje të ardhshme për diskutim mbi ndryshime të mundshme ligjore.

Ky Studim **evidentoi** se ligji nr.97/2013 është në përputhje me Direktivën DSHMAV, si dhe praktikën e shumicës së shteteve anëtare të BE-së, gjë që vjen si rezultat i transpozimit të Direktivës DSHMAV tek legjislacionet e vendeve anëtare ose në proces anëtarësimi me BE.

Studimi **tregoi** se kërkesat për regjistrim dhe procedura të tjera të lidhura me publikimet elektronike, duhet të jenë të kujdeshme, (përveç atyre, që kërkohen për qëllime taksimi, apo biznese), pasi çdo lloj detyrimi apo kërkesë të lidhur me regjistrimin, mund të sjellë efekte të dëmshme për lirinë e medias.

Studimi **konkludoi se** rregullimi i medias online përmes rregullimeve të medias audiovizive, nuk është një praktikë europiane. Po kështu, autoritetet mbikqyrëse të medias audiovizive, sipas legjislacioneve të disa vendeve nuk kanë kompetenca kontrolli ndaj medias online.

Përmes këtij Studimi, **rekomandohet** që, nëse nevoja për të rregulluar median online është e tillë që ky rregullim duhet bërë, standardet e ligjvënësist Shqiptar duhet të orientohen nga interesi

⁷ <https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/albania>

publik i garantimit të lirisë së medias sipas kërkesave kushtetuese, dhe nëse duhet bërë kufizime apo ndërhyrje në lirinë e medias, duke rregulluar funksionimin e medias online, ato duhet të bëhen me ligj, të jenë të justifikuara, dhe proporcionale me interesin publik që i justifikon, pra në respektim të ekuilibrit lidhur me të ashtuquajturat, "të drejta në konflikt". Për më tepër jo rregullimi, por vetrregullimi i medias online do të ishte më i rekomandueshëm, dhe janë vetë aktorët e prekur dhe të përfshirë në këtë proces, bartës të interesave publike, të cilët mund të eksplorojnë se si ky vetrregullim të bëhet me sa më pak kosto/rreziqe për lirinë e shprehjes dhe i pranueshëm si zgjidhje në masë të gjerë.

I. HYRJJE

Ligji nr.97/2013, i miratuar më datë 4 Mars 2013, rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky ligj është hartuar nga Komisioni Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Këshillit të Europës dhe të Komisionit European dhe i konsultuar ndër vite me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit.⁸ Në përputhje me procesin e përafrimit të legjislacionit, në këtë ligj deklarohet se, *është*

⁸ Sipas relacionit bashkëlidhur projekt- ligjit. Për më tepër: Kuvendi.al

përafruar plotësisht me Direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 Mars 2010 "Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë".⁹

Ligji nr.97/2013, zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar. Zbatimi i ligjit nr.97/2013, monitorohet nga AMA, e cila nuk ka asnjë kompetencë ligjore mbi mediat online, për të cilat nuk ekziston një ligj rregullator si në rastin e mediave audiovizive.

Media on line, globalisht por sigurisht edhe në trendin Shqiptar¹⁰, po merr gjithnjë e më shumë terren, me zhvillimet e vrullshme teknologjike, por edhe debati mbi vetrregullimin e Medias¹¹, apo rregullimin nga organe të parashikuara me ligj dhe të krijuara nga shteti, po debatohet gjithnjë e më shumë.¹² Fakti që nuk ka rregulla ligjore të detyrueshme për mediat online në krahasim me mediat audiovizive, do të thotë se nuk ka kufij specifikë të përcaktuar në aspektin e profesionalizmit dhe etikës. Anonimiteti, një tipar i pandarë i internetit dhe rrjedhimisht i medias online, vendos një ton të ri dhe potencial për abuzim në mediat online në krahasim me mediat tradicionale, ku publiku zakonisht e lidh përmbajtjen me fytyrë dhe emër. Për më tepër, përhapja e shpejtë e lajmeve në median online në krahasim me atë tradicionale, si dhe mungesa e mekanizmave vetërregullues, e amplifikon efektin e mundshëm negativ, që mund të ketë kjo media në rastet e sjelljes jokorrekte dhe jo profesionale.¹³

Instituti Shqiptar i Medias në një studim të fundit, arrin në përfundimin se: "*Sjellja etike e mediave online është një nga aspektet më të diskutuara në debatin publik në lidhje me mediat, ndonjëherë duke çuar në propozime për zgjidhje ligjore. Edhe pse përpjekjet e tilla kanë rezultuar të pasuksesshme për momentin, është e qartë se presioni mbi këtë front është në rritje dhe përpjekje të vetë-rregullimit nga mediat do të ishin të preferuara. Mungesa e detyrimeve ligjore ose mekanizmave vetërregullues për të mbikëqyrur sjelljen etike, si dhe praktika e copy-paste janë ndër aspektet që ndikojnë më thellë në profesionalizmin e medias online*"¹⁴.

Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë¹⁵, përmes dy nismave ligjore në Dhjetor 2018, kanë propozuar ndryshimin e ligjit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe ligjin për Median Audiovizuale, me synimin e krijimit të një sistemi regjistrimi të medias në internet, si dhe të gjobitjes e mbylljes së saj, bazuar në shkaqe, të cilat përfshijnë gjykimin, nëse

⁹ Neni 1 dhe 2.

¹⁰ Ankete me Median on line, SOROS- Instituti Shqiptar i Medias, 2018, http://www.osfa.al/sites/default/files/peizash_i_medias_online.pdf

¹¹ Udhëzues për vetrregullimin e mediave, OSBE, 2008, fq.18- "Pesë arsytet pse media duhet të vetregullohet". Për më tepër: <https://www.osce.org/sq/fom/31500?download=true>

¹² <https://www.reporter.al/qeveria-proponon-keshill-censure-per-median-ne-internet/>

¹³ Ankete me Median on line, SOROS- Instituti Shqiptar i Medias, 2018, http://www.osfa.al/sites/default/files/peizash_i_medias_online.pdf fq.16

¹⁴ Ankete me Median on line, SOROS- Instituti Shqiptar i Medias, 2018, http://www.osfa.al/sites/default/files/peizash_i_medias_online.pdf, fq.87-88.

¹⁵ Është marrë mbështetje zyrtare nga OSBE në procesin e modifikimit dhe avancimit në legjislaionin kundër defamacionit dhe rregullave për mediat on-line, njëkohësisht duke respektuar lirinë e shprehjes, medias dhe aksesit në Internet. Për më tepër: <https://ëëë.osce.org/representative-on-freedom-of-media/403625>

një lajm i publikuar në një media të caktuar është apo jo “i paanshëm” apo cënon apo jo “moralin publik”. Të dyja iniciativat janë pjesë e konsultimeve publike aktualisht¹⁶.

Më konkretisht, projekt - ligji për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.97/2013, ka parashikuar në nenin 1, ndryshimin e titullit në **ligjin për mediat audiovizive dhe elektronike**. Në nenin 2 ka zgjeruar fushën e zbatimit të ligjit, **edhe për shërbimet e publikimeve elektronike**. Në nenin 3, ka vënë **detyrimin për regjistrim**, sipas të cilit: "Ofruesi i shërbimit të publikimeve elektronike "është personi fizik ose juridik, i regjistruar në regjistrin e ofruesve të publikimeve elektronike, që ofron shërbime të publikimit elektronik". Po në të njëjtin nen ka dhënë përkufizimin e "**publikimit elektronik**": "Publikimi elektronik", përfshin por nuk kufizohet në programe/publikime, përmbajtja e të cilave, nëpërmjet internetit, transmetohet/publikohet në mënyrë ditore ose periodike, nga ofruesit e publikimeve elektronike, me qëllim informimin, argëtimin dhe edukimin e publikut. Ndërsa në nenin 33 të projekt -ligjit, propozohen shtesa lidhur me **detyrimet e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike**. Ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik duhet të:

- a) sigurojë që publikimet të shfaqen në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive;
- b) sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme;
- c) vendosin masa mbrojtëse për mospërdorimin e tyre për qëllime kriminale;
- ç) mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;
- d) ofrohen për të gjithë përdoruesit njëjloj, pa dallime ndërmjet sekseve, racave, besimit, etnisë apo bindjeve të personave që i përfitojnë ato;
- dh) të mos cenojnë sigurinë kombëtare dhe sigurinë e publikut;
- e) mos cenojnë shëndetin publik;
- ë) respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos lejojë shfaqjen e publikimeve që mund të nxisin vepra penale;
- f) respektojë të drejtat e autorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të;
- g) sigurojë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit;”
- h) të publikojë në mënyrë të qartë dhe të dallueshme informacionin për:
 - i. emrin dhe adresën në rastin e personave juridikë, emri dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar;
 - ii. shenjën/dritaren ku mund të bëhet ankesë për lajmin e publikuar.
- i) të caktojë një person\persona përgjegjës për sektorin\sektorët përkatës të publikimeve emri\emrat dhe adresa\adresat e të cilit\cilëve duhet të publikohen qartësisht. Në caktimin e këtyre personave përgjegjës ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike mbajnë parasysh cilësitë profesionale dhe etiko morale të tyre.

Po ky projekt - ligj ka parashikuar që, Autoriteti i Medias Audiovizuale, i cili aktualisht licencon televizionet dhe radiot, të marrë përsipër të mbikëqyrë edhe **mediat në internet**. Projekt

¹⁶ <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/120>; <http://ama.gov.al/2019/01/14/organizohet-takimi-i-katert-mbi-ndryshimet-ne-ligjin-e-ama-s-dhe-akep-it/>

- ligji ka parashikuar një **procedurë të detajuar mbi ankesat** dhe shqyrtimin e tyre si fillim nga OSHPE- të, dhe më pas pranë Këshillit të Ankesave tek AMA¹⁷. Këshilli i Ankesave mund të vendosë gjobë dhe detyrimin e OSHPE të publikojë formulën e ndjesës sipas vendimit përkatës të shkeljes së konstatuar.

Ndërsa, projekt-ligji për Shtesat në Komunikimet Elektronike, në nenin 2, parashikon se AKEP do të ketë përgjegjësinë “të marrë masa”, që, “sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashtëzakonshme, si dhe të garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të individit si dhe çdo detyrim të parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi në RSH”. Ndërsa në nenin 3, parashikohet se, AKEP-i bashkëpunon me AMA në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe dispozitave të tjera nënligjore si dhe **siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave**, dhe organeve të tjera të AMA, duke detyruar ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet të zbatojnë aktet/vendimet përkatëse të këtyre autoriteteve sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.¹⁸

Edhe dy iniciativat e lartpërmendura ligjore, për të cilat janë organizuar takime dhe konsultime me grupet e interesit reflektojnë këtë shqetësim, pra trendin e zhvillimi të mediave në internet, dhe tendencave të fyerjes, shpifjes dhe denigrimit të personalitetit dhe dinjitetit njerëzor, si dhe mënyrës së vetrregullimit¹⁹ të këtyre mediave, duke respektuar lirinë e shprehjes, në ekuilibër dhe raportin e duhur me standardet e dinjitetit njerëzor dhe të etikës së komunikimit.

Në këtë kontekst, u bë i mundur realizimi i këtij Studimi, që ka si objekt dhe qëllim kryesor:

a) të analizojë kuadrin ligjor Shqiptar për median audiovizuale dhe on -line, si dhe të krahasojë atë me standardet Europiane dhe praktikrat më të mira;

b) të prezantojë gjetje dhe rekomandimet përkatëse, lidhur me ndryshime të mundshme në kuadrin rregullator ligjor Shqiptar.

II. STANDARDET EUROPIANE MBI MEDIAN ONLINE

¹⁷ Udhëzues për vetrregullimin e mediave, OSBE, 2008, fq.48 -49. "Këshilli i shtypit" është forma më e përhapur e një organi vetërregullues. Të përbërë kryesisht nga profesionistë të mediave, këto këshilla janë të pavarur nga pushteti politik. Detyra e tyre kryesore është trajtimi i ankesave rreth punës së mediave, përmes vendimmarrjes kolektive. Duke bërë këtë, ata i ofrojnë publikut garanci për cilësinë e informacionit që merr, demonstrojnë se profesionistët e mediave janë të përgjegjshëm dhe tregojnë që rregullimi i vazhdueshëm i shtetit mbi mediat nuk është i nevojshëm. Secili këshill shtypi i ngritur është unik, rezultat i historisë së veçantë të vendit të tij dhe i mjedisit mediatik. Disa vende kanë ngritur këshilla shtypi prej kohësh: Gjermania, Vendet e Ulëta dhe Skandinave, për shembull. Vende të tjera, si Belgjika, i kanë ngritur ato vetëm kohët e fundit. Ndryshimet demokratike të kohëve të fundit në vende si Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Gjeorgji dhe Armeni kanë sjellë një shpërthim mediash të pavarura, gjë që ka sjellë nevojën për vetërregullim të mediave. Për më tepër: <https://www.osce.org/sq/fom/31500?download=true>

¹⁸ <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/119>

¹⁹ Self-regulation in any profession or sector entails the development and enforcement of rules by those whose conduct is to be governed, with the ultimate aim of improving the service offered to consumers, claimants or – in the case of the media – the public at large. It requires standards to be set and agreed on by the individuals and institutions to which they will apply and the development of procedures and mechanisms for enforcing them. Për më tepër:

<https://www.article19.org/data/files/pdfs/publications/self-regulation-south-east-europe.pdf>

2.1 Bashkimi European dhe vendimet e GJDBE, me fokus median audiovizive dhe online

Direktiva për Shërbimet e Medias Audio- Vizive specifikon se rregullat e parashikuara në të zbatohen vetëm për median audiovizive, duke përfshirë këtu televizionin klasik dhe shërbimet audiovizive në bazë të kërkesës.²⁰ Qëllimi kryesor që Direktiva synon të arrijë është sigurimi i principeve kryesore të Tregut të Lirë European, siç janë konkurenca e lirë, trajtim i barabartë dhe sigurimi i transparencës dhe parashikueshmërisë ligjore në fushën e mediave audiovizive.²¹ Sipas nenit 1(1)(a), një shërbim i medias audiovizive është: “(i) një shërbim në kuptimin e neneve 56 dhe 57 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European, (referuar më poshtë si TFBE), i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimit dhe qëllimi kryesor i të cilit është transmetimi i programeve që informojnë, argëtojnë apo edukojnë publikun e gjerë me anë të sistemeve të komunikimit elektronik, sipas kuptimit që këtij të fundit i është dhënë nga pika (a) e nenit 2 të Direktivës 2002/21/EC; (ii) komunikime reklamuese audiovizive.

Nga më sipër nënkuptohet se duhet të jenë të pranishme shtatë kritere kumulative, në mënyrë që Direktiva të jetë e aplikueshme në një situatë të caktuar²²:

- **Ekzistenca e një shërbimi.** Kjo nënkupton ekzistencën e një konteksti tregtar ku shërbimi ofrohet në këmbim të pagesës. Siç u tha dhe më sipër, “shërbimi” sipas Direktivës merr kuptimin e dhënë nga nenet 56 dhe 57 të TFBE. Neni 57 i TFBE e përkufizon “shërbimin” si “të ofruar zakonisht në këmbim të pagesës”. Siç specifikohet gjithashtu në pikën 21 të Preambulës së Direktivës, ky përkufizim përmbledh çdo formë të aktivitetit ekonomik, por nuk përmbledh aktivitete që janë kryesisht jo ekonomike apo jo në konkurrencë me transmetimet televizive. Konkretisht, këto shërbime nuk përfshijnë oferta në bazën të kërkesës individuale, që nuk kanë natyrë tregtare siç mund të jenë faqe private interneti, dhe as përmbajtje të krijuara nga vetë përdoruesit e një platforme të dedikuar siç është rasti i Youtube²³;
- **Prania e përgjegjësisë editoriale.** Kjo e fundit përkufizohet në nenin 1(1)(c) si ushtrimi i kontrollit efektiv mbi zgjedhjen dhe organizimin e programeve, qoftë në mënyrë kronologjike në rastin e transmetimeve televizive, apo në katalog, në rastin e shërbimeve audiovizive në bazë të kërkesës. Këto të fundit quhen gjithashtu shërbime jo-lineare të medias audiovizive dhe janë të përkufizuara në nenin 1(1)(g) të Direktivës. Përsa i përket ofruesit të shërbimeve të medias audiovizive, Direktiva specifikon në nenin 1(1)(d) se këta të fundit mund të jenë persona fizikë apo juridikë që kanë përgjegjësi editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të shërbimit të medias audiovizuale dhe që vendosin për mënyrën sesi ato organizohen. Vlen të theksohet se ky përkufizim përjashton personat fizikë apo juridikë, të cilët shërbejnë thjesht si transmetues të programeve, përgjegësia editoriale e të cilave qëndron mbi palë të treta.

²⁰ European Audiovisual Observatory (2013) IRIS plus 2013-4, What is an On-demand Service? fq. 8

²¹ Ibid.

²² Ibid. fq.9

²³ Ibid.

- Një qëllim parësor për të ofruar shërbime të medias audiovizive. Pika 22 e Preambulës së Direktivës shpjegon me qëllim parësor nënkuptohet përjashtimi i gjithë shërbimeve ku përmbajtja audiovizuale e ofruar është thjesht rastësore dhe jo qëllimi kryesor i shërbimit. Një shembull mund të jetë një faqe interneti, e cila përmban element grafikë të animuar me informacione për një produkt jo audiovizual;
- Ofrimi i programeve. Koncepti i “programit” saktësohet në nenin 1(1)(b) të Direktivës si një tërësi imazhesh lëvizëse me apo pa zë, të cilat përbëjnë një objekt individual brenda një axhende apo kalendari të përcaktuar nga ofruesi i shërbimit të medias audiovizive, dhe që është i ngjashëm në formë dhe përmbajtje me një program televiziv. Sipas Pikës 23 të Preambulës së Direktivës, termi “audioviziv” përfshin filma pa zë, por përjashton shërbimet radio apo lloje të tjera të transmetimeve audio. Përshkrimi gjithashtu përfshin seksionet e tekstit që shoqërojnë një program, siç mund të jenë titrat, por përjashton shërbimet, të cilat përbëhen vetëm nga teksti, siç mund të jetë rasti i teletekstit. Përsa i përket përkufizimit të programeve mbi bazën e kërkesës, Pika 24 e Direktivës shpjegon se programe në bazë të kërkesës duhen interpretuar si programe të ngjashme me ato të televizionit, pasi sipas këtij përcaktimi, këto programe konkurojnë për të njëjtën audience si transmetimet televizive. Natyra dhe mënyra e aksesit në këto shërbime do ta bënte një përdorues të besonte në mënyrë të arsyeshme ky i fundit do të gëzonte mbrojtjen ligjore të ofruar nga Direktiva edhe për këto lloje programesh. Pika 24 shton se koncepti i “programit” duhet të analizohet dhe kuptohet në mënyrë dinamike, duke marrë parasysh zhvillimet në transmetimet televizive, në mënyrë që të parandalohen pabarazitë në konkurrencë dhe aksesin në tregun e lirë Europian. Gjithashtu, Pika 23 dhe 28 të Preambulës së Direktivës, të lexuara bashkë qartësojnë më tej shtrirjen dhe aplikueshmërinë e Direktivës. Siç u tha dhe më sipër, Direktiva nuk aplikohet mbi shërbimet e përbëra vetëm nga teksti, duke përfshirë këtu edhe versionet elektronike të gazetave apo revistave.
- Programet duhet të jenë me natyrë informative, argëtuese apo edukative. Mungesa e një përkufizimi të saktë nga Direktiva për natyrën e programeve audiovizive, krijon paqartësi mbi kategorizimin e programeve, duke bërë të mundur që konceptet e mësipërme të jenë të aplikueshme për çdo lloj programi audioviziv.
- Nevoja për të adresuar publikun e gjerë, duke nënkuptuar kështu përjashtimin shkëmbime të programeve audiovizive brenda grupeve të vogla të interesit.
- Përdorimi i sistemeve të komunikimit elektronik, duke përjashtuar kështu shitjen e çdo malli fizik. Këto sisteme të komunikimit elektronik, siç u tha dhe më sipër, janë të përkufizuara në nenin 2 (a) të Direktivës 2002/21/EC. Këto sisteme janë “sisteme transmetimi, dhe, kur është e aplikueshme, pajisje routing dhe burime të tjera, përfshirë këtu elemente jo-aktive të rrjetit, të cilat lejojnë transmetimin e sinjalit përmes telave, radio, optike apo mënyra të tjera elektromagnetike, përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet e fiksuara apo tokësore, sistemet e telave elektrikë deri në masën që këto të fundit përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet e radios dhe televizionit, dhe rrjetet e televizionit me tela, pavarësisht llojit të informacionit të

transmetuar”. Ky përkufizim përjashton disa mënyra tradicionale të transmetimit të krijimeve audiovizive, siç janë shfaqja në kinema apo shitja e DVD/BluRay.

Siç mund të kuptohet nga sa u tha më sipër, Direktiva nuk është gjithnjë e qartë dhe shteruese në përkufizimet e saj. Megjithatë, vlen të përmendet se Direktiva imponon detyrime minimale në trajtimin e rregullave mbi mediat audiovizive. Direktiva imponon harmonizimin e koncepteve bazë dhe rezultateve përkatëse, por jo mënyrën dhe mjetin e përzgjedhur të zbatimit nga Vendet Anëtare. Si rrjedhojë, pjesërisht prej natyrës karakteristike të Direktivës si instrument ligjvënës i BE, e pjesërisht prej vetë paqartësisë së disa prej koncepteve të përmbajtura në Direktivë, Vendet Anëtare janë detyruar të gjejnë zgjidhje individuale për shumë pyetje pa një përgjigje në Direktivë.²⁴

Rrjedhimisht, ndërhyrja e GJDBE-së, në qartësimin e kufijve të aplikueshmërisë së Direktivës, si edhe të disa koncepteve kyç të saj, është e pashmangshme. Më poshtë do të shtjellohen dy çështje, të cilat ilustronjë pikërisht sa u tha më sipër.

New Media Online v Bundeskommunikationssenat, C-347/14, vendim i datës 21 Tetor 2015

Rrethanat e çështjes:

Në 2012, Autoriteti Austriak të Medias tentoi të ekzaminonte nëse seksioni i veçantë i një gazete elektronike, i cili përmbante një katalog me rreth 300 video, mund të konsiderohej si një shërbim jo-linear i medias audiovizive.²⁵ Autoriteti Austriak i Medias nuk u përqëndrua tek volumi apo gjatësia e videove, por tek fakti që reportazhet e shumëllojshme audiovizuale në këtë gazetë ishin të krahasueshme me transmetimet televizive dhe adresonin njëkohësisht të njëjtën audiencë si një transmetim televiziv. Rrjedhimisht, duke arsyetuar mbi ekzistencën e konkurrencës midis shërbimeve, Autoriteti Austriak i Medias vendosi se ky shërbim i gazetës elektronike mund të kategorizohej si shërbim në bazë të kërkesës i medias audiovizive. Botuesi nuk ishte dakort me këtë vlerësim, prandaj iu drejtua gjykatave Austriake, të cilat referuan dy pyetje në kërkesën paraprake në GJDBE.

Pyetjet e shtruara për zgjidhje:

A klasifikohen klipet e shkurtra, programe? A përben seksioni video i portalit të gazetës elektronike një shërbim mediatik audioviziv sipas kërkesës?

GJDBE arsyetoi se koncepti i “programit” në nenin 1(1)(b) të Direktivës, duhet interpretuar si term përfshirës i ofrimit të videove të shkurtra të përbëra nga lajme lokale, sportive dhe klipe argëtuese, gjithnjë në kontekstin e një gazete elektronike. Sipas Gjykatës, interpretimi i drejtë i nenit 1(1)(b) të Direktivës kërkon vlerësimin e qëllimit kryesor e ofrimit të videove në versionin

²⁴ Ibid. fq.11

²⁵Media Regulatory Framework and the Online Media – The Macedonian Case fq.13

elektronik të gazetës. Fokusi duhet të qëndrojë mbi natyrën e shërbimit video. Gjykata arsyeton se diferencimi bëhet midis videove, të cilat janë të pavarura në formë dhe përmbajtje nga aktiviteti gazetaresk i operatorit të gazetës elektronike, apo nëse këto video janë thjesht pjesë të pandashme dhe plotësuese të këtij aktiviteti gazetaresk. Në rastin konkret, u vendos se videot në fjalë ishin të veçanta në formë dhe përmbajtje, dhe të pavarura nga aspekti gazetaresk i gazetës. Rrjedhimisht, në zbatim të arsyetimit të Gjykatës së Luksemburgut, Gjykata Federale Administrative e refuzoi apelimin e bërë nga New Media Online, duke rikonfirmuar vendimin e marrë nga Autoriteti Austriak i Medias.²⁶

Peugeot Deutschland v Deutsche Umwelthilfe, Case C-132/17, vendim i datës 21 Shkurt 2018

Rrethanat e çështjes:

Dega e Peugeot në Gjermani kishte postuar në Youtube një video promociionale të një prej veturave të saj. Një shoqatë ambientaliste në Gjermani ngriti padi kundrejt kompanisë me arsyetimin se, video-ja në fjalë nuk përmbante asnjë indikacion përsa i përket konsumit të karburantit dhe emetimeve të dioksidit të karbonit në ajër. Klasifikimi si një shërbim i medias audiovizive apo jo i kësaj video-je është i rëndësishëm, pasi nëse kjo video është e tillë, atëherë sipas legjislacionit Gjerman në fuqi, Peugeot nuk ishte e detyruar të përfshinte informacionet e mësipërme në videon e saj.

Kjo çështje i përket qartësimin të problemeve lidhur me komunikimet reklamuese audiovizive. Këto të fundit janë të përkufizuara në nenin 1(1)(h) të Direktivës si imazhe me apo pa zë, të cilat synojnë promovimin në mënyrë direkte apo indirekte të mallrave, shërbimeve apo imazhe të një personi fizik apo juridik që kryen aktivitet ekonomik. Imazhe të tilla shoqërojnë ose janë të përfshira në programe në këmbim të pagesës, shpërblimeve të tjera të ngjashme ose për qëllime promovimi personal.

Pyetjet e shtruara për zgjidhje:

GJDBE -së iu kërkua përmes kërkesës paraprake, nëse videot promociionale të publikuara nga Peugeot në YouTube mund të kualifikohet si një shërbim mediatik audioviziv brenda kuptimit të DSHMAV.

Vendimi i GJDBE:

Gjykata vlerësoi se një video promociionale në Youtube nuk mund të ketë si qëllimin e saj parësor ofimin e programeve në mënyrë që të informojë, argëtojë apo edukojë publikun e gjerë.

²⁶ Court of Justice of the European Union (2015) *New Media Online v Bundeskommunikationssenat*, Case C-347/14, Judgment of 21 October 2015. Available at <http://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&jur=C,T,F&num=C-347/14&td=ALL>

Gjithashtu, Gjykata shtoi se edhe pse video në fjalë mund deri në një farë mase të informojë, argëtojë apo edukojë disa shikues, siç edhe Peugeot pretendonte, ky efekt ndodh vetëm si rrjedhojë dhe përmes arritjes së qëllimit promocional të vetë video-s. Rrjedhimisht, sipas Gjykatës, edhe nëse një kanal promocional në Youtube do të përmbushte gjithë kriteret dhe karakteristikat e një shërbimi të medias audiovizive të paraqitura në nenin 1(1)(a)(i) të Direktivës, thelbi dhe qëllimi i tij promocional janë të mjaftueshme për ta përjashtuar këtë kanal nga aplikueshmëria e nenit të mësipërm. Si përfundim, Gjykata vlerësoi se kjo çështje referuar nenit 1(1)(a) të Direktivës duhet kuptuar në një mënyrë që përkufizimi i “shërbimeve të mediave audiovizive” nuk përfshin as një kanal videosh si në rastin konkret, as një video të vetme të këtij lloji të konsideruar në izolim. Si pasojë, video-ja në fjalë nuk binte nën juridiksionin e nenit të sipërpërmendur dhe Peugeot nuk mund të përfitonte nga përjashtimi i detyrimit për të dhënë informacionet e kërkuara nga ligji Gjerman për mbrojtjen dhe informimin e konsumatorit.²⁷ Ky vendim sqaroi çështjen e komunikimit tregtar audioviziv.

(...)

Dy vendimet e përshkruara më sipër janë shembuj të mirë përse i përket ilustrimit të aplikueshmërisë, shpeshherë të komplikuar të Direktivës si dhe të dilemave të autoriteve të medias apo gjykatave në gjykimin e çështjeve të lidhura me këtë Direktivë. Gjithashtu, këto vendime janë orientuese të fushës së veprimit të Direktivës, e cila është më e ngushtë në praktikë, sesa mund të duket nga një lexim i shpejtë i neneve të saj.

Në vijim paraqiten disa legjislacioni, për qëllime krahasimore lidhur me konceptet dhe përkufizimet e shërbimeve audiovizive, publikimeve elektronike, programeve apo dhe portaleve në internet, si dhe autoritetet monitoruese mbi median audiovizive sips legjislacioneve përkatëse.

Sipas Ligjit për Median Elektronike, në **Malin e Zi**,²⁸ është dhënë përkufizimi i "shërbimeve të mediave audiovizive", i "medias elektronike" dhe i "programit"²⁹. Po në këtë ligj, është parashikuar autoriteti rregullator, i titulluar Agjencia për Mediat Elektronike, jo me kompetenca kontrolli mbi median online³⁰.

²⁷Court of Justice of the European Union (2018) Peugeot Deutschland v Deutsche Umwelthilfe, Case C-132/17, Judgment of 21 February 2018. Available at <http://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&jur=C,T,F&num=C-132/17&td=ALL>

²⁸ <https://www.epra.org/articles/media-legislation#MONTENEGRO>

²⁹ neni 8: 1) AVM service means a service under editorial responsibility of an AVM service provider the principal purpose of which is the provision of programs in order to inform, entertain or educate, to the general public by electronic communications networks, and may take the form of electronic media (radio or television broadcast), an on demand AVM service or audiovisual commercial communication; 3) **electronic media (a linear AVM service)** means a radio or television broadcast which presents a set of information in the form of images and/or sound or combination thereof (audiovisual content) constituting an individual item, under the same name, intended to inform and meet the cultural, educational, social and other needs of the public, which enables simultaneous listening to and/or viewing of programs on the basis of a program schedule; 5) programme means a set of moving images with or without sound constituting an individual item within a schedule or a catalogue established by an AVM service provider and whose form and content is comparable to the form and content of television or radio broadcasting; audiovisual commercial communication means including in a programme a set of images with or without sound designed: (a) to promote, directly or indirectly, the goods, services or image of a natural or legal entity pursuing an economic activity, in return for payment or for similar consideration or (b) for self-promotional purposes;

³⁰ neni 10-14 i ligjit.

Sipas ligjit për Median në **Maqedoninë e Veriut**, Agjencia për Shërbimet Audio Vizuale dhe Audio, është autoriteti rregullator në fushën e Medias³¹.

Sipas Ligjit për Media Elektronike në **Kroaci**³², parashikohet se, "media elektronike" si "programe audiovizuale, programe radioje dhe botime elektronike", dhe "publikime elektronike", si: "përmbajtje të programuara të programeve të cilat ofruesit e botimeve elektronike transmetojnë çdo ditë ose periodikisht nëpërmjet internetit me synimin për të ofruar informacion dhe edukim publik" (neni 2³³). Ky ligj parashikon se: (1) Liria e shprehjes dhe liria e programit të plotë të mediave elektronike do të garantohen. (2) Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të sigurojë të drejtën e censurës ose kufizimit të lirisë së fjalës dhe shprehjes së mendimit, (neni 3).

Sipas nenit 80 të Ligjit, "Personi fizik ose juridik është i detyruar të paraqesë kërkesë për regjistrim në Regjistrin e ofruesve të botimeve elektronike, e cila mbahet pranë Këshillit të Mediave Elektronike, para transmetimit të parë të publikimit elektronik".

Sipas Ligjit të Medias në **Sllloveni**³⁴, parashikohet: "media masive" si, gazeta dhe revista, shërbime të radios dhe televizionit, botime elektronike, teletext dhe forma të tjera të programeve të formuluar editorialisht të publikuara çdo ditë ose periodikisht nëpërmjet transmetimit të materialit të shkruar, materialeve vokale, tingujve ose fotografive në mënyrë të qasshme publiku", dhe "programi", si; informacione të të gjitha llojeve, (lajme, mendime, njoftime, raporte dhe informacione të tjera) dhe vepra me të drejtën e autorit të shpërndara përmes mjeteve të informimit publik, duke përbushur nevojat kulturore, arsimore dhe të tjera të publikut, dhe komunikimin në baza masive", (neni 2³⁵). I njëjti nen parashikon se, termi "masmedia", nuk mbulon buletinë, katalogë, forma të tjera të publikimit të informacionit të dedikuar ekskluzivisht për reklamim, komunikim biznesi, procese arsimore ose punë të brendshme të kompanive, institucioneve dhe fondacioneve, shoqërive, partive politike dhe kisha

³¹ https://cdn.epra.org/organisations/documents/54/original/Profile_MK_0219.pdf?1550763691

³² <https://www.epra.org/articles/media-legislation#CROATIA>

³³ Article 2 (1) For the purposes of this Act particular terms have the following meaning:

1 **Electronic media**: audiovisual programmes, radio programmes and electronic publications.

2 **Electronic publications**: edited programme contents which the electronic publications providers broadcast daily or periodically via the Internet with a view to provide public information and education.

3 **Audiovisual media service**: a service as defined by Articles 56 and 57 of the Stabilisation and Association Agreement between the Republic of Croatia and European Communities and their Member States, which is under the editorial responsibility of a media service provider and the principal purpose of which is the provision of programmes in order to inform, entertain or educate, to the general public by electronic communications networks within the meaning of the provisions of Electronic Communications Act. Such an audiovisual media service is either a television broadcast or an on-demand audiovisual media service and/or audiovisual commercial communication as defined in this Act.

³⁴ https://www.rtvsl.si/files/razno/mass_media_act.pdf

https://www.akos-rs.si/files/APEK_eng/Legislation/Digital-Broadcasting-Act-EN.pdf

³⁵ Neni 2, (1): Under the present Act mass media are newspapers and magazines, radio and television programme services, electronic publications, teletext and other forms of editorially formulated programme published daily or periodically through the transmission of written material, vocal material, sound or pictures in a manner accessible to the public. (2) Under the present Act programme comprises information of all types (news, opinion, notices, reports and other information) and works under copyright disseminated via mass media for the purpose of informing the public, satisfying the public's cultural, educational and other needs, and communicating on a mass basis. (3) The term "mass media" does not cover bulletins, catalogues, other forms of publication of information intended exclusively for advertising, business communication, educational processes or the Internal work of companies, institutions and foundations, societies, political parties, and church and other organisations, school gazettes, the Official Gazette of the Republic of Slovenia and the official gazettes of local communities, other official publications, posters, pamphlets, brochures and transparencies, and video pages without moving pictures (unpaid reports), unless stipulated otherwise by law.

dhe organizata të tjera, gazeta shkollore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë dhe gazetat zyrtare të komuniteteve lokale, botime të tjera zyrtare, postera, pamflete, broshura dhe parulla, dhe faqe video pa fotografi lëvizëse, (raporte të papaguara) me ligj.

Ky Akt nuk i jep asnjë kompetencë autoritetit rregullator të Medias, për të rregulluar botimet elektronike. Në rast të shkeljeve, kompetenca për miratimin e vendimeve për kundërvajtje dhe gjoha i takon Inspektoratit të Kulturës dhe Mediave të Republikës së Sllovenisë, i cili është një organ nën përgjegjësinë e Ministrisë së Kulturës, që mbikqyr zbatimin e legjislacionit që lidhet me kulturën dhe mediat. Rregullimi i mediave audiovizive rregullohet nga një akt tjetër, Akti i Shërbimeve të Medias Audiovizive, i cili nuk përfshin asnjë dispozitë lidhur me publikimet elektronike³⁶.

Sipas Ligjit Federal "Për shtypin dhe mediat e tjera të botimit", në **Austri**³⁷, parashikohet se: "medium elektronik periodik" është një "medium", që transmetohet në mënyrë elektronike (programi i transmetimit) ose, b) shkarkohet (uebfaqja) ose, c) shpërndahet në një përbërje të krahasueshme të paktën katër herë në vit, (medium i përsëritur elektronik). Qëllimi i ligjit është ruajtja e të drejtës për lirinë e informimit dhe shprehjes, garantimi i lirisë së plotë të mediave, mbrojtja e gazetarëve, dhe përgjegjësia e medias.

Ky Akt nuk i jep asnjë kompetencë autoritetit rregullator të medias, (Komm Austria) për të rregulluar mediat në internet. Rregullimi i mediave audiovizive rregullohet nga një akt tjetër, Akti Federal për Shërbimet e Medias Audiovizuale³⁸.

2.2 Këshilli i Europës dhe vendimet e GJEDNJ, me fokus median online

Përsa i përket legjislacionit dhe rregullave të zbatueshme nga Këshilli i Europës, instrumenti ligjor më i ngjashëm me Direktivën, është Konventa Europiane e Televizionit Ndërkufitar. Megjithatë, kjo Konventë është thujse e papërfillshme, duke qënë se është e pandryshuar që prej adoptimit të saj në 1989.³⁹

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në Rekomandimin e saj CM/Rec, (2011) 7 "Mbi një nocion të ri të mediave", ka ofruar një listë kriteresh, që synojnë t'i ndihmojnë shtetet anëtare të vlerësojnë se çfarë mund të jetë "një nocion i ri i gjerë i mediave"⁴⁰. Sipas këtij Rekomandimi, ligjvënësit janë të inkurajuar të marrin parasysh disa kritere dhe rregulla bazë për të përcaktuar dhe përkufizuar saktë në legjislacionet përkatëse se cilat aktivitete, pjesëmarrës dhe shërbime duhet të trajtohen si pjesë e "medias". Këto rekomandime janë:

- Qëllimi për të vepruar si një media, indikacione të të cilit janë: vetë-etiketimi si media, mënyra e operimit e tipike për një media, përkushtim ndaj standarteve profesionale

³⁶ Macedoina case- Comparative analysis and recommendations as to possible amendments to the legal framework. Për më tepër: <https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/-/a-new-study-is-out-media-regulatory-framework-and-the-online-media-the-macedonian-case>

³⁷ https://www.ris.bka.gv.at/Dokumente/ErV/ERV_2001_1_84/ERV_2001_1_84.pdf

³⁸ https://www.ris.bka.gv.at/Dokumente/ErV/ERV_2001_1_32/ERV_2001_1_32.pdf §1. Neni 1: (1) In order to administer and carry out regulatory tasks relating to electronic audio media and electronic audio-visual media, including supervision of the Austrian Broadcasting Corporation and its subsidiaries, the Austrian Communications Authority ("KommAustria") shall be established.

³⁹ Media Regulatory Framework and the Online Media – The Macedonian Case fq. 18.

⁴⁰ Available at https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cc2c0

mediatike, anëtarësi në grupime mediatike si dhe marrëveshje për të transmetuar prodhimet mediatike tek publiku i gjerë;

- Synimi dhe objektivat themelues të një media, të cilat mund të përfshijnë: prodhimin, përmbledhjen dhe shpërndarjen e materialeve mediatike si dhe operimi i aplikacioneve apo platformave të ideuara për thjeshtëzimin e komunikimit interaktiv në masë;
- Prania e kontrollit editorial, siç janë ekzistenca e një politike editoriale, proceseve editoriale dhe stafit;
- Prania e standarteve profesionale siç janë respektimi i etikës profesionale, deontologjia, ekzistenca e procedurave të përpunueshmërisë dhe ankimit, si edhe përfitimi nga mbrojtja apo privilegjet profesionale siç janë mbrojtja apo mbajtja sekret e burimeve;
- Niveli dhe cilësia e shpërndarjes së informacionit tek publiku i gjerë;
- Pritshmëritë e publikut, tregues të cilave mund të jenë: pritshmëria publike që një media të jetë lehtësisht e aksesueshme dhe e vazhdueshme, pritshmëria e pluralizmit dhe diversitetit mediatik si edhe respektimi i standarteve profesionale të llogaridhënies dhe transparencës.

Ky rekomandim ka marrë në konsideratë nga njëra anë qasjen më të gjerë që i takon nocionit të medias, (që përfshin në një farë mase rrjetet sociale dhe lojra online), por nga ana tjetër hesht për regjimin (et) rregullator që duhet të zbatohen për këto media (nëse ka).⁴¹

Rekomandimi e merr këtë çështje në konsideratë, vetëm kur sugjeron shtetet anëtare të "rishikojnë nevojat rregullatore në lidhje me të gjithë aktorët, që ofrojnë shërbime ose produkte në ekosistemin e medias, në mënyrë që të garantojë të drejtën e individëve për të kërkuar, marrë dhe për të dhënë informacion në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe t'u japë këtyre aktorëve mbrojtje përkatëse kundër ndërhyrjeve, që mund të ndikojnë negativisht në të drejtat e nenit 10, duke përfshirë situatat që rrezikojnë të çojnë në mbingarkesë të panevojshme ose vetëcensurim".

Gjithashtu, në këtë Rekomandim theksohet se: "... si një formë e ndërhyrjes, rregullimi i medias duhet të përputhet me kërkesat e domosdoshmërisë së rreptë dhe ndërhyrjen minimale, kornizat specifike rregullatore duhet t'i përgjigjen nevojës për të mbrojtur mediat nga ndërhyrja. (...) Çdo veprim i kërkuar ndaj mediave në lidhje me përmbajtjen duhet të respektojë ligjet në fuqi; mbi të gjitha standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të respektojnë masat mbrojtëse procedurale. Duhet të ketë prezumim në favor të lirisë së shprehjes dhe informacionit dhe në favor të lirisë së medias.

Në Rekomandimin CM/Rec (2015), 6 "Mbi rrjedhën e lirë, ndërkufitare të informacionit në internet", Komiteti i Ministrave i KE, ka ofruar standarde të vlefshme për qëllimin e këtij Studimi, duke ripohuar se: *"Shtetet duhet të mbrojnë dhe promovojnë globalisht rrjedhjen e lirë të informacionit në internet. Ata duhet të sigurojnë që ndërhyrjet në trafikun në*

⁴¹ Konkluzion i nxjerrë dhe nga studimi "MEDIA REGULATORY FRAMEWORK AND THE ONLINE MEDIA - Macedonian case".

(Comparative analysis and recommendations as to possible amendments to the legal framework). Për më tepër: <https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/-/a-new-study-is-out-media-regulatory-framework-and-the-online-media-the-macedonian-case>

internet brenda territorit të tyre, të ndjekin qëllimet legjitime të përcaktuara në nenin 10 të KEDNJ dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare përkatëse dhe të mos kenë një ndikim të panevojshëm ose joproportional në rrjedhën ndërkufitare të informacionit në internet".

Këshilli i Evropës thekson se: "Shtetet duhet të kenë kujdes për shkak të vlerësimit, zhvillimit dhe zbatimit të politikave të tyre kombëtare, me qëllim identifikimin dhe shmangien e ndërhyrjeve me trafikun në internet, që kanë një ndikim negativ në rrjedhën e lirë ndërkufitare të informacionit në internet".⁴²

Kjo nënkupton marrjen parasysh të elementëve vijues:

- *Vlerësimi*: masat rregullatore që janë në gjendje të kenë një ndikim të tillë duhet të vlerësohen në lidhje me përgjegjësinë e shtetit për të respektuar, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të sanksionuara në KEDNJ.

- *Transparenca, parashikueshmëria, llogaridhënia*: kur zhvillohen korniza politike dhe rregullatore që mund të ndikojnë në rrjedhën e lirë të informacionit në Internet. Shtetet duhet të sigurojnë transparencën, duke përfshirë rezultatet e vlerësimeve të përmendura më lart, parashikueshmërinë për zbatimin e tyre dhe llogaridhënien. Në veçanti, kuadri rregullator i propozuar duhet të publikohet duke ndjekur procedurat e duhura dhe me kohë të mjaftueshme për të lejuar komentet publike.

- *Proporcionaliteti dhe rishikimi i masave*: Shtetet janë të detyruara të sigurojnë që bllokimi i përmbajtjes ose shërbimeve, që konsiderohen të paligjshme duhet të jenë në përputhje me nenet 8, 10 dhe 11 të KEDNJ. Në veçanti, masat e miratuara nga autoritetet shtetërore për të luftuar përmbajtjen e paligjshme ose aktivitetet në internet nuk duhet të rezultojnë në një ndikim të panevojshëm dhe joproportional përtej kufijve të shtetit. Shtetet duhet të përpiqen të zhvillojnë masa që janë më pak ndërhyrëse dhe më pak shkatërruese dhe t'i zbatojnë ato pas një procesi transparent dhe të përgjegjshëm. Masat e miratuara ose të promovuara nga shtetet duhet të rishikohen rregullisht për të përcaktuar efektivitetin e tyre praktik, dhe nëse ato janë ende të nevojshme apo proporcionale.

Rekomandimi i Këshillit të Ministrave CM/Rec (2007) 2, "Mbi pluralizmin e mediave dhe shumëllojshmërinë e përmbajtjes mediatike", ka theksuar se: "*...Në mënyrë që të mbrohet dhe promovohen aktivisht opinionet, shprehjet dhe idetë pluraliste, si dhe shumëllojshmëria kulturore, Shtetet Anëtare duhet të adoptojnë një kuadër ekzistues rregullator, veçanërisht në lidhje me pronësinë e mediave dhe të adaptojnë çdo masë financiare dhe rregullatore me qëllim që të garantojnë transparencën e medias dhe një pluralizëm strukturual si dhe një shumëllojshmëri të përmbajtjeve të përcjella publikut.*

Ky Rekomandim përcakton se: "*Shtetet anëtare duhet të përpiqen të sigurojnë një shumëllojshmëri kanalesh mediatike, të ofruara nga një gamë pronarësh të ndryshëm si privatë dhe publik. Kur zbatimi i rregullave të përgjithshme të konkurrencës në sektorin e mediave dhe rregullimi i aksesit në to, nuk janë të mjaftueshëm për të garantuar zbatimin e kërkesave për sa i përket shumëllojshmërisë kulturore dhe shprehjes pluraliste të ideve dhe të mediave, shtetet anëtare duhet të miratojnë masa të veçanta. Shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë miratimin e rregullave që kanë për qëllim kufizimin e ndikimit, që një person i vetëm, një shoqëri*

⁴² Available at : https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805c3f20

apo grup mund të ketë, në një ose më shumë sektorë të medias si dhe të sigurojnë një numër të mjaftueshëm të kanaleve mediatike. Këto rregulla duhet t'i përshtaten masës dhe karakteristikave të veçanta të mediave audio-vizuale apo tregut të mediave të shkruar, kombëtare, rajonale ose lokale, për të cilat zbatohen".

Përsa i përket çështjeve të lidhura me mediat, e më specifiku me ato on-line apo audiovizive, GJEDNJ ka vendosur standarde kryesisht për probleme të lidhura vetëm me dy nene të Konventës; nenin 8 dhe nenin 10. Vlen të përmendet se GJEDNJ nuk ka trajtuar çështje, të cilat i përkasin fushës së mediave audiovizive, ndryshe nga GJDBE siç u përkrahua dhe më sipër. Çështjet më të afërta me ato të bazuara në Direktivën më sipër, janë çështjet e lidhura me përgjegjësinë e portaleve apo operatorëve të mediave on-line për komentet dhe veprimtarinë e palëve të treta në faqet e tyre.

Edhe pse këto çështje nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me median audiovizive si edhe me përkufizimin apo shtrirjen e këtij koncepti prej Direktivës, ato janë të rëndësishme në kontekstin e projektligjeve të propozuara së fundmi, të cilat parashikojnë kritere kontrolluese dhe mekanizma gjobitje apo dënime për mediat on-line sipas parashikimeve ligjore.

Në çështjen **Delfi kundër Estonisë**, GJEDNJ, analizoi ndërhyrjen e portaleve tek komentet dhe liria e shprehjes së lexuesve dhe komentuesve, duke konfirmuar përgjegjësinë e portaleve për fshirjen e komenteve negative.⁴³

Delfi, një ndër portalet kryesore mediatike online të Estonisë, publikoi në vitin 2006, një lajm të lidhur me një kompani transporti detar (SLK). Lajmi kishte të bënte me shkeljen prej kësaj kompanie të rregullave të lundrimit të aplikueshme në atë kohë. Një numër i madh lexuesish komentuan mbi lajmin e publikuar nga Delfi. Disa prej këtyre komenteve nxisnin dhunë dhe shfaqnin urrejtje për aksionerin kryesor të SLK. Gjashtë javë pas publikimit të komenteve, aksioneri në fjalë i kërkoi Delfit të fshinte komentet nga faqja e tyre. Këta të fundit, pas kërkesës së bërë, i fshinë komentet duke i konsideruar ato si shkelje të të drejtave individuale të aksionerit. Edhe pse komentet u fshinë, gjykatat në Estoni e dënuan Delfin me arsyetimin se duhej të kishte parandaluar këto komente qartësisht të paligjshme.

GJEDNJ aplikoi parimin e proporcionalitetit, sipas të cilit, me vendosjen e penalteteve civile, ishte ndërhyrë në lirinë e shprehjes, por kjo ndërhyrje ishte bërë me ligj, dhe kishte si qëllim të ligjshëm, mbrojtjen e reputacionit të të tjerëve. Sipas GJEDNJ, ndërhyrja mbi lirinë e shprehjes së portalit ishte proporcionale dhe e nevojshme për të arritur qëllimin në një shoqëri demokratike. Për rrjedhojë, gjykata vendosi, se Estonia kishte vepruar në mënyrë proporcionale, dhe se nuk kishte shkelur nenin 10 të KEDNJ.

GJEDNJ theksoi se: "*...në rastin e publikimit të informacionit në media, botuesi mund të jetë një kompani mediale, si dhe personi që ka transmetuar informacionin në publikimin e medias. Botimi i lajmeve dhe komenteve në një portal në internet është gjithashtu një aktivitet gazetaresk. Në të njëjtën kohë, për shkak të natyrës së mediave të internetit, nuk mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga një operator portali për të redaktuar komentet para publikimit, në të njëjtën mënyrë si për një botim të shtypit. Ndërsa botuesi i një mediumi të shkruar, është, nëpërmjet redaktimit, iniciuesi i publikimit të një komenti, në portale, iniciatori i*

⁴³ <https://strasbourgobservers.com/?s=delfi>

botimit është autori i komentit, i cili e bën atë të qasshme për publikun e gjerë përmes portalit. Prandaj, operatori i portalit është jo personi për të cilin është dhënë informacioni. Për shkak të interesit të tyre ekonomik në botimin e komenteve, si një botues i medias së shkruar dhe një operator i internetit janë sipërmarrës. Ndërhyrja nga një operator i portalit në internet me lirinë e shprehjes së personave, që paraqesin komente është megjithatë e justifikuar nga detyrimi i operatorit portal-sipërmarrës për të respektuar nderin dhe emrin e mirë të palëve të treta.⁴⁴

Sipas GJEDNJ, ku bëhet fjalë për të drejta konventore konkurruese si ato të garantuara nga neni 8 dhe neni 10, shtetet kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi, duke përcaktuar dhe pikën e ekuilibrit mes tyre, në varësi të konteksteve kombëtare. Për të realizuar vlerësimin e proporcionalitetit, GJEDNJ ka identifikuar disa aspekte specifike si: sa e nevojshme është liria e shprehjes në rastin në fjalë, siç mund të jenë konteksti i komenteve, masat e zbatuara nga portalet, me qëllim parandalimin ose fshirjen e komenteve fyese, përgjegjësia e autorëve të komenteve, si një alternativë tjetër si dhe pasojat sipas procedurave të brendshme kombëtare për portalin.

Si klonkluzion, bazuar në çështjen Delfi, portalet e lajmeve on-line, të cilat lejonin përdoruesit e tyre të komentonin, mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e komenteve të palëve të treta të publikuara online, edhe kur: a) operatori i faqes online nuk është në dijeni të këtyre komenteve; dhe, b) edhe nëse operatori i fshin komentet mbasi është lajmëruar për ekzistencën e tyre.

Në çështjen, **MTE – Index v Hungari**⁴⁵, GJEDNJ analizoi çështje të lidhura me përgjegjësinë për palë të treta komentuese online, njësoj si tek Delfi sa i përket fakteve. Kështu, MTE dhe Index, në faqen e tyre online, publikuan një opinion se si dy kompani imobiliare Hungareze përdornin praktika jo-etike kontraktuale në punën e saj, dhe i bënë thirrje lexuesve, që të ishin në dijeni të kësaj ngjarjeje. Disa komentues të këtij portali shprehën opinionet e tyre në mënyrë ofenduese dhe vulgare, por pa përdorur doza urrejtjeje në fjalët e tyre. Kompanitë e pasurive të paluajtshme nuk kontaktuan MTE, një organizëm vetrregullues, dhe Index, portalin online, por i paditën në gjykatë. Edhe pse, pas padisë, komentet u fshinë, gjykatat Hungareze vendosën se portalet ishin përgjegjëse në mënyrë ekskluzive për komentet online të palëve të treta.

GJEDNJ, ritheksoi se, edhe pse jo publikues në kuptimin tradicional të fjalës, portalet online, në parim kanë disa "detyra dhe përgjegjësi" për lajmet dhe informacionet që publikojnë. Megjithatë, sipas GJEDNJ gjykatat Hungareze nuk kishin respektuar si duhet nocionin e përgjegjësisë së aplikantit, duke vlerësuar lirinë e shprehjes së tij me të drejtën për reputacion të mirë tregtar të dy kompanive të pasurive të paluajtshme në mënyrë joproportionale.

Duke aplikuar testin proporcionalitetit, i njëjtë si për Delfi, dhe duke marrë në konsideratë elementet dhe ndryshimet në çështjen MTE – Index v Hungari⁴⁶, GJEDNJ vendosi se

⁴⁴ Çështja 64569/09, Kompania Delfi AS kundër Republikës së Estonisë, 15 qershor 2016.

⁴⁵ Magyar Tartalomszolgáltatók Egyesülete and Index.hu Zrt v. Hungary, nr. 22947/13

⁴⁶ Në ndryshim nga Delfi, ku komentet e postuara përmbanin urrejtje dhe kërcënime për jetën e një njeriu, komentet në MTE dhe INDEX ishin thjesht vulgare dhe fyese, por jo qartësisht të jashtëligjshme. Një tjetër faktor që vlen të krahasohet është natyra dhe qëllimi i publikuesit. Delfi ishte një ndër portalet më të mëdha online, ku aftësia e lexuesve për të komentuar ishte një aspekt përbërës i aktivitetit të tyre tregtar. Nga ana tjetër, MTE ishte thjesht një shoqëri jo- fitim-prurëse, përfaqësues interesash për grupe të caktuara, por jo interesa ekonomike të njohura, dhe nuk kishte si qëllim parësor publikimin e lajmit. Gjithashtu, identiteti

Hungaria kishte dështuar në balancimin e të drejtës së privatësisë dhe asaj të lirisë së shprehjes, e si rrjedhojë vendimi i gjykatave Hungareze u konsiderua në shkelje të nenit 10 të KEDNJ.⁴⁷

Në çështjen **Magyar Jeti Zrt v. Hungary**⁴⁸, aplikuesi ishte një kompani që zotëronte një portal online shumë të njohur në Hungari. Ky portal hodhi në internet një artikull të një gazetari të një media lidhur me disa sulme ndaj fëmijëve të një shkolle të komunitetit Rom. Gjatë artikullit, portali referonte tek një buton, ku po ta klikoje dilte e ngarkuar në Youtube video, intervista e një drejtuesi të një komuniteti Rom, lidhur me disa sulme të bëra ndaj një shkolle që shumicën e nxënësve i kishte nga ky komunitet. Ky drejtues akuzonte një parti politike të quajtur Jobbik, dhe anëtarët e saj për këtë sulm. Kjo parti hodhi në gjyq për shpifje dhe dëmtin reputacioni të gjitha faqet e mediave që kishin publikuar, apo shumëfishuar intervistën e drejtuesit të komunitetit Rom dhe kishin keqinformuar mbi sulmin e krijuar, në fakt nga tifozë sporti, dhe jo nga anëtarë të kësaj partie, si dhe aplikuesin, që kishte ngarkuar videon në portalin e saj. Kjo parti pretendoi se duke përdorur termin Jobbik për të përshkruar sulmuesit e shkollës, dhe duke publikuar hiperlinkun në Youtube video, kishin dëmtuar reputacionin e saj, përmes shpifjes. Gjykatat Hungareze i dhanë të drejtë.

Pyetja e shtruar para GJEDNJ, ishte nëse, sipas rrethanave konkrete të kësaj çështje, ndërhyrja tek e liria e shprehjes ishte bazuar në arsye të mjaftueshme dhe të duhura, dhe për rrjedhojë të nevojshme në një shoqëri demokratike sipas KEDNJ.

Sipas Gjykatës, publikimi i hyperlinks nuk përbën automatikisht shpërndarje të informacionit shpifës. Prandaj, duhen vlerësuar rast pas rasti, situatat që duhet të merren parasysh për të konkluduar nëse një portal online duhet të ketë përgjegjësi për publikimin e një hyperlink, duke iu referuar këtyre aspekteve:

1. A e ka miratuar gazetari përmbajtjen e kundërshtuar?
2. A e përsëriti gazetari përmbajtjen e kundërshtuar?
3. A referoi gazetari thjesht një hyperlink ndaj përmbajtjes së kundërshtuar, (pa miratimin apo përsëritjen e tij)?
4. A e dinte ose mund të kishte kuptuar në mënyrë të arsyeshme gazetari se përmbajtja e kundërshtuar ishte e natyrshme së shpifjes apo ndryshe e paligjshme?
5. A ka vepruar gazetari me mirëbesim, a e ka respektuar etikën e gazetarisë dhe tregon kujdesin e duhur që pritet, në gazetarinë e përgjegjshme?⁴⁹

Nën dritën e rrethanave konkrete të çështjes, GJEDNJ vendosi se ka patur shkelje të nenit 10 të KEDNJ, nga autoritetet Hungareze. Gjithsesi, GJEDNJ theksoi se kur një gazetar "nuk vepron në mirëbesim në përputhje me etikën e gazetarisë dhe me kujdesin që pritet nga një gazetar i përgjegjshme, që merret me çështje me interes publik" edhe nëse ai ose ajo thjesht përsërit një deklaratë, është e mundur diskutimi i çështjes së përgjegjësisë⁵⁰.

i personit të cënuar nga komentet është gjithashtu një element i rëndësishëm. Në rastin e Delfit, personi ishte një individ, ndërsa në rastin e MTE bëhej fjalë për një person juridik.

⁴⁷ <https://blogs.lse.ac.uk/mediapolicyproject/2016/02/19/the-european-court-of-human-rights-rules-again-on-liability-for-third-party-comments/>

⁴⁸ Magyar Tartalomszolgáltatók Egyesülete and Index.hu Zrt v. Hungary ECtHR nr. 22947/13

⁴⁹Ibid, prg.77

⁵⁰ ibid, prg.80

Këto vendime janë dëshmuere të kompleksitetit të rregullimit me ligj dhe balancimit të drejtave në botën virtuale. Megjithatë, GJEDNJ ka theksuar se në rastet kur procedurat efektive editoriale u japin mundësinë portaleve të përgjigjen në mënyrë të shpejtë, qasja e fshirjes së përmbajtjes së ndaluar mbas lajmërimit nga pala e dëmtuar do të jetë, në shumicën e rasteve, e mjaftueshme për balancimin efektiv të të drejtave dhe interesave të palëve të përfshira.⁵¹

GJEDNJ, pas vendimit Delfi, në një vendim të mëvoshëm, **PHIL kundër Suedisë**, ka sqaruar *përgjegjësinë e kufizuar të operatorëve të faqeve të internetit ose platformave online, që përmbajnë përmbajtje shpifëse të krijuara nga përdoruesit*⁵². Sipas GJEDNJ, *blogjet jo-fitimprurëse nuk mbajnë përgjegjësi për shpifjen e komentuesve, nëse pas një kërkesë nga i dëmtuari ata e heqin komentin*. Në këtë çështje, aplikuesi nuk ishte pronar ose operator i një platforme online, me komentet e përdoruesve që ankoheshin për një ndërhyrje në të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes sipas nenit 10 të Konventës. Aplikanti, ishte një person privat, që u ankua për shkelje të së drejtës së tij për privatësi dhe reputacion sipas nenit 8 të KEDNJ-së, sepse autoritetet suedeze nuk kishin pranuar të bënin përgjegjës operatorin e një faqeje interneti përgjegjës për një blog me postim shpifës dhe një koment anonim online.⁵³

Ndërsa, në çështjen **Tamiz kundër Mbretërisë së Bashkuar**, GJEDNJ u shpreh se, blogjet e google - si ofruet të shërbimeve të publikimit, nuk mbajnë përgjegjësi për komentet fyese. Në këtë vendim theksohet se: *"Për sa kohë që nocioni i respektit, nuk është koncept i prerë shkurt dhe i qartë", dhe mund të mbrohet në forma dhe mënyra të ndryshme, zgjedhja e mënyrave për respektimin e këtij detyrimi, i mbetet hapësirës së vlerësimit të shteteve anëtare*". Nën dritën e këtyre konsideratave, GJEDNJ theksoi se: *"fakti është se miliona përdorues interneti, postojnë komente ofenduese çdo ditë, por shumica janë të padobishme në karakterin e tyre, për të arritur të dëmtojnë reputacionin e personit tjetër*. Në këtë kuptim, GJEDNJ vërejtë se: *"aplikanti ishte një politikan karriere, dhe duhet të ketë një kufi tolerance të lartë, edhe pse komentet e z.Tamizi ishin postuar në korrik 2010 - para se ai t'i bashkohej Partisë Konservatore"*. Duke konsideruar se aplikanti kishte dhe opsione të tjera veprimi kundër autorit të blogut dhe komenteve, Gjykata vendosi se pretendimet e aplikantit nuk plotësojnë kufirin e "dëmit real dhe substancial", si kërkesa për procedurat mbi shpifjen dhe testin e ekulibrit mes nenit 8 dhe 10 të Konventës.⁵⁴

"Dëmi" është një kriter që varet nga dallimet e ndryshme themelore ligjore sipas legjisllacioneve kombëtare, në kuadër edhe "elementëve të dëmit", sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Dallimet kombëtare padyshim e komplikojnë harmonizimin e ligjeve dhe qasjen e njëjtë në nivel ndërkombëtar. GJEDNJ ka argumentuar se: "Interneti është një mjet informacioni dhe komunikimi veçanërisht i dallueshëm nga mediat e shkruara, në veçanti, përse i përket aftësia për të ruajtur dhe transmetuar informacionin. Rrjetet

⁵¹ <https://blogs.lse.ac.uk/mediapolicyproject/2016/02/19/the-european-court-of-human-rights-rules-again-on-liability-for-third-party-comments/>

⁵² Çështja Rolf Anders Daniel Pihl kundër Suedisë, 9 mars 2017

⁵³ <https://strasbourgobservers.com>

/2017/03/20/pihl-v-sweden-non-profit-blog-operator-is-not-liable-for-defamatory-users-comments-in-case-of-prompt-removal-upon-notice/

⁵⁴ Çështja Tamiz Kundër Mbretërisë së Bashkuar, 12 tetor 2017, prg. 81-82- 87-89.

elektronike, që i shërbejnë miliarda përdoruesish në mbarë botën nuk janë dhe potencialisht nuk mund t'i nënshtrohet të njëjtave rregullave dhe kontrolleve. Rreziku i dëmit, i ekspozuar nga përmbajtja dhe komunikimet në internet, në ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, është sigurisht më e lartë se ajo e paraqitur nga shtypi i shkruar.⁵⁵

Padyshim ekzistojnë dallime midis qasjeve të miratuara përmes ligjeve, nga legjislationet e shteteve europiane, për të rregulluar përmbajtjen në internet. Përmbajtja e konsideruar si e dëmshme ose ofenduese nuk bie gjithmonë brenda kufijve të paligjshmërisë. Zakonisht, ndryshimi midis përmbajtjes së paligjshme dhe të dëmshme është se e para është kriminalizuar nga ligjet kombëtare, ndërkohë që kjo e fundit konsiderohet fyese, e pakëndshme, ose të padëshirueshme, por në përgjithësi nuk konsiderohet kriminale. Zhvillimet ligjore në lidhje me internetin, kanë treguar se shtetet kanë diferenca në kuptimin e kategorizimit ose etiketimit për të caktuar llojet e përmbajtjes si "të paligjshme", ose "të dëmshme"⁵⁶.

III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME KYÇE

Mbi ligjin e Mediave Audiovizive

Ligji nr. 97/2013 është i përafuar plotësisht me standartin e Direktivës 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 "Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë", dhe përmbajtjen e saj, si pasojë e procesit të përafrimit të ligjeve të Shqipërisë me *acquis communariae* të BE. Gjithashtu, edhe terminologjia e ligjit është plotësisht e përafuar me Direktivën. Shumica e terminologjisë është marrë prej Direktivës dhe implementuar në mënyrë identike në ligj.

Disa nga konceptet kyçe të unifikuara nga Direktiva dhe të transpozuar nga ligji janë: përkufizimet e 'shërbimeve mediatike audiovizive' si: "një shërbim nën përgjegjësinë editoriale të një operatori të shërbimit mediatik, qëllimi kryesor i të cilit është ofrimi i programeve informuese, argëtuese ose edukuese, për publikun e gjerë, nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik. Një shërbim i tillë mediatik audioviziv është ose një transmetim televiziv ose një shërbim mediatik audioviziv, sipas kërkesës dhe/ose një komunikim tregtar audioviziv, sipas përcaktimeve të këtij ligji"; 'shërbimet audiovizive, sipas kërkesës' të cilat janë: "shërbimet jolineare mediatike audiovizive të ofruara nga ofruesi i shërbimit mediatik në momentin e zgjedhur nga përdoruesi, në bazë të kërkesës së tij, mbështetur në një katalog programi të ofruar për këtë qëllim nga ofruesi i shërbimit mediatik"; 'Transmetimi Linear' dhe 'Transmetimi jolinear', që përkufizohen përkatësisht si: "ofrimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv për marrje të njëkohshme të tyre nga dëgjuesit dhe/ose shikuesit", dhe "ofrimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv për marrje, sipas kërkesës individuale dhe në momentin e zgjedhur nga përdoruesit"; apo edhe koncepti i 'Reklamës' i përshkruar si: "çdo formë e

⁵⁵ Editorial Board of Pravoye Delo and Shtetkel v. Ukraine, Application no. 33014/05, Judgment of 05.05.2011, para 63.

⁵⁶ Freedom of expression on the internet, OSBE, 2012. Studim për vendet e përfshira në OSBE.

publikimit të transmetuar kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera nga një sipërmarrje publike ose private apo nga një person për qëllime vetëreklamuese, lidhur me veprimtari të veta tregtare e fitimprurëse, profesionale ose ekspertizë, si dhe për mbështetjen e pajisjes me mallra ose shërbime, përfshirë këtu pasuri të paluajtshme, të drejta e detyrime të tjera, përkundrejt pagesës”. Përsa i përket shtrirjes dhe aplikueshmërisë, të trajtuara në nenin 2, ky ligj është përsëri tërësisht i përafuar me Direktivën. Kjo nënkupton se shërbimet e transmetimeve tradicionale, apo shërbimet lineare të medias audiovizive, janë të përfshira në juridiksionin e ligjit. E njëjta mund të thuhet edhe për shërbimet jo-lineare të medias audiovizive. Po ky nen përjashton qartazi zbatueshmërinë e ligjit mbi median e shkruar. Në këtë mënyrë, ligji është në të njëjtën linjë me shumicën e vendeve të BE. Nga ana tjetër, rregullimi i medias online përmes rregullimeve ligjore të medias audiovizive, nuk është një praktikë europiane, konkluzion i nxjerrë dhe nga studime të tjera të bëra për këtë qëllim⁵⁷.



Mbi ndryshimet potenciale të ligjit për Median Audiovizive dhe ligjin për Komunikimet Elektronike

Standardet e Këshillit të Europës në lidhje me median i njohin “hapësirën e vlerësimit” shtetit përkatës, si në instrumentet me të cilat operojnë, ashtu edhe për mënyrën se si mund të arrijnë qëllimet dhe pikësynimet e interesit të përgjithshëm në nivel kombëtar lidhur me garantimin e lirisë së shprehjes, por edhe të ruajtjes së dinjitetit njerëzor, duke respektuar ballancën mes këtyre dy vlerave kushtetuese themelore për të drejtat e njeriut.

Nevoja apo jo e një ligji specifik për mediat, ku rrjedhimisht do të rregullohej me ligj aspekti i mediave online, është një debat i gjatë, i thelluar dhe jashtë objektivit të kësaj analize. Nëse nevoja për të rregulluar median online është e tillë që ky rregullim duhet bërë, standardet e ligjvënësist, duhet të orientohen nga interesi publik i garantimit të lirisë së medias sipas këtyre standardeve ndërkombëtare dhe kushtetuese:

- çdo ndryshim të jetë i përcaktuar me ligj. Përcaktimi me ligj përfshin aksesueshmërinë dhe parashikueshmërinë e ligjit, pra norma të krijohet me saktësi të mjaftueshme për subjektet që preken nga ligji, të parashikojë masën që është e arsyeshme në rrethanat përkatëse, si dhe pasojat që mund të vijnë nga përfshirja në një aktivitet të caktuar.

- këto ndryshime duhet të jenë të nevojshme. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përfshin detyrimet dhe përgjegjësitë. Ajo mund të kufizohet vetëm në kushte, dhe sanksione të parashikuara në mënyrë strikte nga ligji dhe që në një shoqëri demokratike përbëjnë masat e nevojshme dhe ekskluzive, me qëllim të: mbrojtjes së sigurisë kombëtare, mbrojtjes së integritetit territorial, mbrojtjes së sigurisë publike, mbrojtjes nga trazirat dhe krimet, mbrojtjen e shëndetit, mbrojtjen e moralit, reputacionin ose të drejtat e të tjerëve, parandalimin e përhapjes së

⁵⁷MEDIA REGULATORY FRAMEWORK AND THE ONLINE MEDIA - Macedonian case- (Comparative analysis and recommendations as to possible amendments to the legal framework). Për më tepër: <https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/-/a-new-study-is-out-media-regulatory-framework-and-the-online-media-the-macedonian-case, fq.23>

informacionit konfidencial ose ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Secila nga këto arsye është analizuar nga praktika gjyqësore e GjEDNJ, prandaj dhe duhet konsideruar.

- këto ndryshime të jenë proporcionale për të arritur qëllimin e ndjekur. Shteteve Palë i jepet një hapësirë e caktuar në vlerësimin e ekzistencës së një "nevoje urgjente sociale", nga zbatimi i masave kufizuese dhe në zgjedhjen e masave⁵⁸. Shteti ka kufizime në këtë vlerësim dhe gjithmonë duhet të ofrojë "shpjegime të domosdoshme dhe bindëse" mbi testin e proporcionalitetit. Në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron "ekuilibrimi i drejtë i interesave", vlerësimi i rëndësishëm dhe objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit, nëse: (i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin- ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t'u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.

Disa konsiderata, apo orientime për Ligjvënësin, në kushtet e rregullimeve apo bërjes së një ligji të ri, do të ishin:

- Ligjvënësi duhet të sigurohet se asnjë ndryshim i ligjeve ekzistuese apo krijimi i një ligji të ri, do të dobësonte lirinë e medias dhe të shtypit duke krijuar detyrime të mëtejshme administrative. Siç vihet re edhe në shembujt ekzistues, ligji duhet të ketë qartësisht si objektivi të tij, garantimin dhe mbrojtjen e lirisë së mediave.
- Nevoja për të mbajtur detyrimet administrative në minimumin e mundshëm. Ndryshimet apo ligjet e reja nuk duhet të kenë si objektivi kryesor shtimin e procedurave dhe kërkesave administrative për të strukturuar ligjërisht funksionimin e mediave. Mungesa e një ligji specifik për median nuk është justifikim i mjaftueshëm për imponimin e masave dhe detyrimeve administrative, pasi një mungesë e tillë nuk nënkupton vakum ligjor. Deri më sot, mediat të cilat nuk janë audiovizive kanë qënë rregullisht subjekte të ligjeve të ndryshme tregtare, penale, civile dhe tatimore. Rrjedhimisht, amendimi apo prezantimi i një ligji të ri duhet të ketë objektivi parësor thjeshtësimin dhe përmbledhjen e kuadrit ligjor në një instrument të vetëm. Në këtë mënyrë zbatimi dhe respektimi i ligjit do të ishte me i thjeshtë dhe më efikas.
- Është e rëndësishme që ligji të mos krijojë diferencime artificiale midis koncepteve të medias. Duke pasur parasysh se qartësia dhe parashikueshmëria do të ishin shtytësit kryesorë për ekzistencën e një ligji të tillë, diferencimi artificial midis mediave të shkruara, atyre online si dhe shërbimeve lineare apo jo-lineare që nuk janë audiovizive,

⁵⁸ Në këtë këndvështrim, GjEDNJ-ja ka theksuar: "Zgjedhja e mjeteve me anë të të cilave arrihen qëllimet për garantimin e lirisë së shprehjes mund të variojnë sipas kushteve kombëtare dhe për këtë arsye bien brenda marzhit të vlerësimit të vetë shtetit." (çështja Manole dhe të tjerët kundër Moldovës, vendim i datës 17 dhjetor 2009, § 100).

nuk do t'i shërbente qëllimit. Në kohën kur shërbimet lineare dhe jo-lineare janë të pranishme njëkohësisht në të njëjtin portal apo kur mediat e shkruara kanë thuajse gjithmonë prezencë online, ligji i ri duhet të sigurohet se dispozitat e tij të jenë gjithëpërfshirëse dhe të barabarta. Përndryshe mund të rrezikohet krijimi i standardeve dhe rregullave të ndryshme për subjekte specifike që operojnë në të njëjtën fushë, duke dëmtonuar rrjedhimisht konkurueshmërinë e tregut.

- Pavarësisht se është një sfidë e vazhdueshme në Shqipëri, vetërregullimi i medias është faktor thelbësor në funksionimin e sistemit mediatic. Kodi i Etikës, i cili është mjete i vetëm i vetërregullimit të mediave në Shqipëri, nuk përbën detyrim ligjor dhe nuk përfshin mediat online.⁵⁹ Ligji i ri mund të shërbejë rrjedhimisht si incetivizues i përditësimit të Kodit të Etikës, dhe si kontrollues i zbatueshmërisë së tij.

❖ Përmbledhje propozimesh

1. Ligji nr. 97/2013 është në përputhshmëri të plotë me Direktivën 2010/13/EU të Parlamentit Europian dhe Këshillit Europian. Në këtë aspekt, legjislacioni Shqiptar nuk ka nevojë për ndryshime. Përsa i përket interpretimit dhe zbatimit të saktë të koncepteve të ligjit, gjykatat shqiptare mund të referohen të çështjet e GJDBE, të përmendura më sipër.
2. Përveç mediave audiovizive, llojet e tjera të medias nuk janë të rregulluara me një ligj të posaçëm në Shqipëri. Nevoja për një ligj të tillë është e diskutueshme. Në kuadrin e amendimeve të diskutuara së fundmi, apo nëse Ligjvënësi vendos të krijojë një ligj të tillë, disa objektiva thelbësore duhet të merren parasysh, ku më kryesori është liria e medias.
3. Në objektivin për të arritur qartësi dhe thjeshtësi në zbatim, është e nevojshme që detyrimet dhe procedurat administrative të parashikuara nga ligji i ri, të jenë të mjaftueshme për të arritur qëllimin e tyre dhe jo në tejkalim të qëllimit.
4. Ligji duhet të jetë gjithëpërfshirës në natyrë dhe nuk duhet të krijojë diferencime artificiale midis koncepteve të “vjetra” dhe të “reja” të medias. Në të kundërt, rrezikohet prishja e konkurrencës në treg.
5. Ligji i ri mund të shërbejë si nxitës për vetërregullimin e mediave dhe zbatueshmërisë së këtyre rregullave.

• ANEKSE

- Ligji nr.97/2013

⁵⁹Kodi i Etikës së Medias Shqiptare (2006). Për më shumë: <http://www.osce.org/sq/albania/21235?download=true>
<https://www.reporter.al/manualidrejtises/download/LIRIA%20E%20SHPREHJES%20DHE%20E%20MEDIAS.pdf> fq.3

- Projekti- ligji "Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
- Projekti- ligji "Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

• BIBLIOGRAFIA

- Directive 2010/13/EU of the European Parliament and of the Council of 10 March 2010 on the coordination of certain provisions laid down by law, regulation or administrative action in Member States concerning the provision of audiovisual media services (Audiovisual Media Services Directive), codified version, OJ L 95/1.
- Court of Justice of the European Union (2015) *New Media Online v Bundeskommunikationssenat*, Case C-347/14, Judgment of 21 October 2015.
- Court of Justice of the European Union (2018) *Peugeot Deutschland v Deutsche Umwelthilfe*, Case C-132/17, Judgment of 21 February 2018.
- Council of Europe – Committee of Ministers (2015) *Recommendation CM/Rec(2015)6 on the free, transboundary flow of information on the Internet*.
- Council of Europe – Conference of Ministers responsible for Media and Information Society (2013) *Resolution on preserving the essential role of media in the digital age*.
- Council of Europe – Committee of Ministers (2011) *Recommendation CM/Rec(2011)7 to member states on a new notion of media*.
- Council of Europe – Committee of Ministers (2011) *Recommendation CM/Rec(2011)8 to member States on the protection and promotion of the universality, integrity and openness of the Internet*.
- EPRA (2011) *33rd EPRA meeting – Plenary session – Content Regulation and new Media: Exploring Regulatory Boundaries between Traditional and new Media*.
- Article 19 (2005) *Freedom and accountability: safeguarding free expression through media self-regulation*, International Federation of Journalists.
- High Level Group on Media Freedom and Pluralism (2013) *A free and pluralistic media to sustain European democracy*.
- OSCE Representative on Freedom of the Media (2008) *The media self-regulation guidebook*.
- OSCE Representative on Freedom of the Media (2013) *The online media self-regulation guidebook*.
- Puddephat, Andrew (2011) *The importance of self-regulation of the media in upholding freedom of expression*. UNESCO Communication and Information Debates n°9.
- GJEDNJ, Kompania Delfi AS kundër Republikës së Estonisë, 15 qershor 2016
- GJEDNJ, Rolf Anders Daniel Pihl kundër Suedisë, 9 mars 2017
- GJEDNJ, Manole dhe të tjerët kundër Moldovës, 17 dhjetor 2009
- GJEDNJ, Europa Qendrore 7.S.R.L dhe Di Stefano kundër Italisë, 7 qershor 2012
- GJEDNJ, Lingens kundër Austrisë, 8 korrik 1986

- GJEDNJ, Tamiz kundër Mbretërisë së Bashkuar, 12 tetor 2017
- GJEDNJ, Magyar Jeti Zrt v. Hungary, vendim 4 dhjetor 2018
- GJEDNJ, Magyar Tartalomszolgáltatók Egyesülete and Index.hu Zrt v. Hungary, vendim 4 dhjetor 2018
- MEDIA REGULATORY FRAMEWORK AND THE ONLINE MEDIA - Macedonian case
- Anketë me Median on line, Instituti Shqiptar i Medias, financuar nga SOROS, 2018.